

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODRNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-10-0013

Në padinë e

██████████ **Shoqëria Aksionare**

Prishtinë

Paditësi

vs.

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

RR. Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë

2. ██████████ Shoqëria Aksionare

██████████ Prishtinë

Të paditurat

██████████ **Sh.P.K**

██████████ Prishtinë

Përfaqësuar nga ██████████ avokat nga Prishtina,

██████████

Ankuesi

Për: Ankuesin

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Kolegji i Ankesave i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Grupit Aragosta, Kompani me Përgjegjësi të Kufizuara kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 27 tetor 2009 (SCC-09-0151), pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 prill 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.
2. Ankuesi është i obliguar që të paguaj për Dhomën e Posaçme taksën gjyqësore në shumë prej 60,-- Euro për procedurën ankimore.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 27 tetor 2009, Trupi Gjykses ka nxjerrë një aktvendim në lëndën nr. SCC-09-0151, SH.A. [REDAKTUAR] (Prishtinë) kundër 1. Agjencisë Kosovare të Privatizimit/ 2. Ndër. së Re [REDAKTUAR] (Prishtinë), duke e aprovuar masën e ndalimit të përkohshëm të kërkuar nga paditësi dhe duke e ndaluar Agjencinë Kosovare të Privatizimit të zhvillojë çfarëdo procedure që ka të bëjë me privatizimin e Sh.A. [REDAKTUAR] (Prishtinë). Dhoma e Posaçme ka vendosur gjithashtu se masa e ndalimit të përkohshëm do të mbetet në fuqi deri në një aktvendim përfundimtar të Dhomës së Posaçme në këtë lëndë. SH.A. [REDAKTUAR] (Prishtinë) ishte e obliguar të depozitojë pranë Dhomës së Posaçme, brenda 3 (tre) ditëve bankare, që nga dita e pranimi të aktvendimit të përmendur më lart, shumën prej 5.000 eurove për të kompensuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit për çfarëdo dëmi nëse padia nuk vërtetohet. SH.A. [REDAKTUAR] (Prishtinë) është këshilluar që në rast se nuk deponohet garancia bankare pa ndonjë arsye valide, do të mund të ketë si pasojë tërheqjen *ex officio* të masës së ndalimit të përkohshëm.

Ankuesi e ka ushtruar ankesën kundër këtij aktvendimi më 27 janar 2010.

Kolegji i Ankesave më 10 shkurt 2010 ka lëshuar një urdhër duke kërkuar nga Ankuesi që brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i urdhrit, të dorëzojë kopjen e aktvendimit kundër të cilit është bërë ankesa, përfshirë dhe kopjen e dëftesës së pranimi të aktvendimit, përkthimin në gjuhën angleze të dokumenteve përcjellëse të ankesës, përfshirë autorizimin, kopjen e vërtetuar të autorizimit me të cilën autorizohet avokati i Ankuesit dhe duke e pasur parasysh se nga formulimi i ankesës del se Ankuesi nuk ka marrë pjesë si palë në

procedurën gjyqësore të shkallës së parë, ai të japë një sqarim mbi argumentet ligjore në të cilat është bazuar ankesa e tij kundër aktvendimit të kontestuar.

Ankuesi e ka konfirmuar marrjen e këtij urdhri më 15 shkurt 2010. Më 27 shkurt 2010, Ankuesi i ka dorëzuar disa dokumente, disa nga të cilat vetëm në gjuhën shqipe. Është dorëzuar edhe një deklaratë mbi argumentin ligjor në të cilën është bazuar ankesa e tij kundër aktvendimit të kontestuar. Gjithashtu, Ankuesi ka përfshirë në parashtresat e tij edhe një konfirmim nga Oda e Avokatëve të Kosovës, sipas së cilës përfaqësuesi i Ankuesit është regjistruar si avokat në regjistrin e Odës së Avokatëve të Kosovës që nga 5 shtatori 2001. Asnjë nga dokumentet e dorëzuara në parashtresat e Ankuesit në gjuhën shqipe apo angleze në urdhrin e Dhomës së Posaçme të datës 10 shkurt 2010 nuk e përfshijnë autorizimin e vërtetuar. Gjithashtu, nuk janë dorëzuar disa përkthime që janë kërkuar.

Arsyet Ligjore:

Ankesa është e papranueshme për arsyet vijuese:

1. Ankuesi nuk ka të drejtë t' i bashkohet procedurës gjyqësore duke parashtruar ankesë i vetëm .

Pasi që Ligji i RSFJ-së mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77, 36/80, 69/82) dhe "Ligji i ri Kosovar mbi Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006)" nuk e kundërshtojnë njëri tjetrin sa i përket përkufizimeve relevante në këtë lëndë, Kolegji i Ankesave nuk ka nevojë të marrë qëndrim se cili ligj është i aplikueshëm. Ankesa e Ankuesit është e papranueshme cilito ligj që të aplikohet, për arsyet e dhëna më poshtë.

Neni 271.2 i "Ligjit Kosovar mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006)" thotë: "Ndërhryësi mund të hyjë në procesin gjyqësor gjatë gjithë procedurës që përfundon me marrjen e formës së prerë të vendimit mbi kërkesëpadinë, si dhe gjatë procedurës që iniciohet me mjete goditjeje të jashtëzakonshme." Më tutje, neni 273.2 i "Ligjit Kosovar mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006)" thotë: "Po që se ndërhyrësi ka hyrë në procesin kontestimor deri në momentin

kur vendimi mbi kërkesëpadinë është bërë i formës së prerë, ai ka të drejtë ta paraqesë edhe mjetin e jashtëzakonshëm të goditjes së vendimit të këtillë." Të dyja këto përkufizime tregojnë se ndërhyrësi, çka Ankuesi dëshiron të bëhet, ka të drejtë të hyjë në procedurën ekzistuese por jo të iniciojë procedurën e zakonshme ankimore vet pa pjesëmarrjen paraprake në procedurë.

Neni 206 i Ligjit të RSFJ-së mbi Procedurën Ankimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77, 36/80, 69/82) thotë: "Personi që ka interes juridik që në kontestin, i cili vazhdon midis personave të tjerë, njëra nga palët të ketë sukses mund ti bashkohet kësaj pale. Ndërhyrësi mund të hyjë në kontestim gjatë gjithë procedurës gjithnjë gjersa vendimi mbi kërkesë-padinë të ketë marrë formën e prerë, si dhe gjatë procedurës së vazhduar me paraqitjen e mjetit juridik të jashtëzakonshëm. [...]" Më tutje, neni 208 i Ligjit të RSFJ-së mbi Procedurën Ankimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77, 36/80, 69/82) thotë: "Ndërhyrësi duhet ta pranojë kontestimin në atë gjendje në të cilën ndodhej në momentin kur ka ndërhyrë në kontestim. Në procesin e mëtejshëm të kontestimit ai është i autorizuar të parashtrojë propozime dhe të ndërmarrë të gjitha veprime të tjera kontestimore brenda afateve në të cilat këto veprime do të mund t' i ndërmernte pala të cilës i është bashkuar. Në qoftë se ndërhyrësi ka hyrë në kontestim pasi vendimi mbi kërkesë-padinë të ketë marrë formën e prerë, është i autorizuar të paraqesë edhe mjetin e jashtëzakonshëm juridik. [...]"

Këto përkufizime gjithashtu tregojnë se pala e tretë nuk ka të drejtë të iniciojë vet procedurën e zakonshme ankimore vetëm. Prandaj, Kolegji i Ankesave e përsërit atë çka ka thënë lidhur me Ligjin Kosovar mbi Procedurën Kontestimore. Hyrja e palës së tretë në një padi pas nxjerrjes së aktvendimit të shkallës së parë është e mundshme vetëm nëse palët e rregullta (ose njëra nga to) paraprakisht (ose në të njëjtën kohë) kanë mundësuar mjetin juridik kundër aktvendimit. Çdo interpretim tjetër i ligjit do të shkelte parimin kryesor të disponimit të palës, e cila është e përbashkët në shumicën e sistemeve civile ligjore evropiane dhe e paraparë me nenin 3 të Ligjit të RSFJ-së mbi Procedurën Kontestimore si dhe në nenin 3 të Ligjit Kosovar mbi Procedurën Kontestimore.

Prandaj, Ankuesi nuk ka të drejtë të hyjë në procedurë mes palëve të shkallës së parë duke parashtruar një ankesë pranë Kolegjit të Ankesave nëse palët nuk

kanë parashtruar një ankesë të tillë. Prandaj, Ankesa në fjalë është e papranueshme.

2. Gjithashtu, Ankuesi nuk ka ofruar autorizim të vërtetuar dhe disa nga përkthimet që janë kërkuar nga Kolegji i Ankesave përmes urdhrimit për sqarim të datës 10 shkurt 2010, çka gjithashtu e bën ankesën të papranueshme.

Neni 28.2 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thotë sa vijon:

"Padia është e pranueshme vetëm nëse:

(f) Parashtresat janë paraqitur në përputhje me kushtet nga nenet 25 dhe 27 të kësaj Urdhërese Administrative."

Neni 58.2 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thotë:

"Rregullorja e punës dhe dëshmitë që e udhëheqin procedurën e paneleve gjyqësore vlejnë mutatis mutandis për procedurën e panelit të ankesave. "

Ankesa nuk i përmbush kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në Nenin 60 dhe Nenin 28.2 në lidhje me Nenin 58.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Ankuesi është këshilluar nëpërmjet urdhrimit të datës 10 shkurt 2010 brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve nga pranimi i urdhrimit, të dorëzojë dokumentet e lartpërmendura, dhe është paralajmëruar se në rast se nuk arrin të parashtojë një ankesë të kompletuar apo të korrigjuar e cila plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 28.2 (f) të UA të UNMIK-ut 2008/6 (lidhur me nenin 58.2 leg cit) brenda afatit të paraparë, atëherë Kolegji i Ankesave do ta refuzojë ankesën mbi bazat e papranueshmërisë.

Ankuesi nuk e ka përmbushur plotësisht këtë urdhër. Ai nuk e ka dorëzuar autorizimin e vërtetuar dhe disa nga përkthimet gjithashtu nuk janë siguruar. Prandaj ankesa është e papranueshme dhe duhet të refuzohet sipas nenit 61.4 të UA të UNMIK-ut 2008/4, gjithashtu edhe për këto arsye.

Aktvendimi i Trupit Gjyqësor i datës 27 tetor 2009 mbetet në fuqi.

3. Sipas nenit 11 të RREG 2008/4 dhe nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjyqësor merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në

shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët.

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme ka lëshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, që janë në fuqi që nga data 10 mars 2010.

Aty thuhet kështu:

‘Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me “Tarifat e Taksave Gjyqësore” – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën e ankimeve para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Plotësuese Procedurale hyjnë në fuqi më 10 mars 2010 dhe vlejné deri më 31 dhjetor 2010.’

Taksat gjyqësore në të dyja shkallës përbëhen nga, në njërin anë një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi është shkallës së parë është lëshuar një ditë para hyrjes në fuqi të rregullave të lartpërmendura, këtu do të shqyrtohen vetëm taksat gjyqësore për procedurën e ankimeve:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore (“ADJ”) është 30,-- Euro.

VII

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklaratimet për vlerën e padisë. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Në përgjithësi, për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euro

Taksat gjyqësore do të barten nga Ankuesi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it	nënshkruar
Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it	nënshkruar
Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it	nënshkruar
Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it	nënshkruar